



TERMA REFERENCE

Për subjektin/ekspertin përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e projektit

- **Detyrat**

Kandidati i përzgjedhur do të jetë përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

1. Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve monitoruese dhe vlerësuese mbi objektivat e projektit
2. Hartimi i një Plani për Monitorimin e Performancës dhe mbikëqyrja e zbatimit e rishikimi periodik i tij;
3. Rishikimi dhe dhënia e komenteve ndaj planeve të projektit sa i përket monitorimit të performancës së indikatorëve, realizimit të objektivave, arritjes së target grupeve, etj.
4. Kontribuimi në rishikimin e performancës së sistemit të vlerësimit të aktiviteteve, si dhe në zhvillimin e përmirësimit të mjeteve mbështetëse për performancën e projektit;
5. Zhvillimi i monitorimit të aktiviteteve dhe prodhimi i raporteve të vlerësimit, të cilat do të përfshijnë vlerësimin e indikatorëve dhe synimeve (*targets*);
6. Kontribuimi në planifikimin dhe raportimin e projektit, sa i përket aspekteve monitoruese, vlerësuese dhe kualitative
7. Zhvillimi i konsultimeve me aktorët relevantë për të marrë të dhëna prej tyre (takime fizike në terren ose online me qëllim grumbullimin ose vlerësimin e të dhënave të projektit)
8. Zhvillimi i aktiviteteve planifikuese, kontrolluese të cilësisë dhe pajtueshmërisë (compliance).
9. Mbwshtetja e stafit zbatues të projektit për të analizuar rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat e planifikuara dhe vlerësimi i mjeteve e metodave të përdorura për arritjen e tyre.
10. Mbwshtetja e stafit zbatues të projektit në zhvillimin dhe përditësimin e planit të aktiviteteve, raportimeve periodike të ndërmjetme e finale të projektit.
11. Mban komunikime të rregullta me partnerët dhe palët e interesuara, nën konsultimin paraprak me stafin e projektit, mbi performancën e projektit bazuar në gjetjet e të dhënave nga monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të tij.

- **Kritere pranueshmërie**

1. Nivel edukimi Master në Statistika, Shkenca Sociale apo fusha të tjera të ngjashme e relevante (në rast se aplikanti është individ)
2. Eksperiencë minimale 5-vjeçare, lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e projekteve kombëtare/ndërkombëtare.



3. Të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës angleze (B2-C1)
4. Të ketë njohuri të mira praktika të paketës *Microsoft Office* (kryesisht *Word*, *Excel*, *Powerpoint*)
5. Të ketë përvoja të mëparshme në monitorimin e aktiviteteve dhe projekteve; përgatitjen e strategjive, planeve apo dokumentave raportues; si dhe planifikimin e koordinimin e aktiviteteve me synim mbledhjen e informacionit nga aktorët relevantë

KËRKESË PËR OFERTË

PËR NJË SUBJEKT TREGTAR/EKSPERT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E PROJEKTIT

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) po zbaton nismën “Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, mbështetur financiarisht nga Zyra Britanike e Punëve të Jashtme, *Commonwealth*-it dhe Zhvillimit dhe zhvilluar në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Politike, Qëndresën Qytetare dhe Balkan Investigative Reporting Network (BIRN) Albania

KShH fton të gjitha subjektet e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al, deri në datën 28.04.2023 dokumentacionin e mëposhtëm:

1. CV (ku të pasqyrohet qartësisht përmbushja e kriterëve të thirrjes)
2. Ofertën financiare në Lekë për realizimin e shërbimit të monitorimit dhe vlerësimit të projektit.
3. Një tipologji të shkurtër të metodologjisë së monitorimit, e cila do të zbatohet për projekin në fjalë.
4. Evidenca të përvojave të mëparshme të subjektit/ekspertit në kryerjen e detyrave të ngjashme (preferohen vlerësime të OShC-ve në formën e letër rekomandimeve apo letër mbështetëse)
5. Vlera e ofertës duhet të llogaritet nga subjektet e interesuara me TVSh të përfshirë në çmim
6. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe/ose e vulosur